

VENDIM
Nr. 481, datë 16.7.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 180, DATË 26.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PAGESËN E VLERËS SË MBETUR PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 31.7.2012, PËR ANKIMET NR. 604/07, 43628/07 DHE 46684/07, “MANUSHAQE PUTO DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 dhe 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 10, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 180, datë 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në të gjithë përmbajtjen e vendimit fjalët “... ankimet nr. 604/07, 43628/07 dhe 46684/07 ...”, zëvendësohen me “... ankimet nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09 ...”.

2. Në fund të pikës 4 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në rast mospagimi brenda këtij afati, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.”.

3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Efekti financiar për zbatimin e këtij vendimi të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama